



Në mbështetje të Ligjit të Punës në Kosovë, Kontratën Kolektive dhe Statutit të Kompanisë, Menaxhmenti i Kompanisë i K.R.U. "Radoniqi" SH.A.- Gjakovë, përpilon këtë:

RREGULLORJA MBI TË ARDHURAT PERSONALE NË BAZË TË VLERËSIMIT TË PUNËVE DHE DETYRAVE TË PUNËS

Neni 1

Të gjitha punët dhe detyrat e punës karakterizohen sipas shkallës së ndërlikueshmërisë dhe rëndësisë së tyre në realizimin e rezultateve të punës , siç është përcaktuar më afër në Rregulloren mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Punëve dhe Detyrave të Punës.

Neni 2

Kompanija do të bëjë vlerësimin e punëve dhe detyrave të punës sipas nevojave të saj dhe kushteve të punës , të përcaktuara me Rregulloren mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Punëve dhe Detyrave të Punës.

Neni 3

Llogaritjen e pagave në kompani ndërlidhet me specifika të caktuara. Llogaritja e pagave bëhet veçanërisht për secilin duke i konsideruar të gjitha elementet të cilat ndikojnë në formimin e pagave .

Të punësuarit realizojnë pagën në bazë të:

- 3.1. Në bazë të realizimit të punës (rroga bazë);
- 3.2. Përvojës në punë;
- 3.3. Stimulimit;
- 3.4. Kushteve të posaçme në punë;
- 3.5. Volumit të punëve dhe stazhit të praktikantit;
- 3.6. I punësuarit realizon edhe pjesën e pagës si kompensim i shpenzimit të shujtjes gjatë punës .

Neni 4

Pagat bazë

Bazat e pagës së punëtorit për orarin e plotë të punës prej 40 orësh në javë përcaktohen në varshmëri të ndërlíkueshmërisë së punëve, përgjegjësisë, kualifikimit dhe kushteve të punës në vend të punës. Paga bazë paraqet shkallën e caktuar për secilin vend pune.

Neni 5

Sipas llojit dhe ndërlíkueshmërisë së punëve dhe detyrave të punës, kërkohet përgatitja profesionale e nevojshme për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës e cila përcaktohet dhe kategorizohen si më poshtë:

Neni 6

Kategoria e I ndërlíkueshmërisë së punëve – Përgatitja profesionale-Punëtor i pa kualifikuar

Punë të thjeshta të përbëra nga numri i vogël i operacioneve të ndryshme dhe afatshkurta, të cilat për shkak të karakteristikave teknologjike mund të kryhen me përpjekje dhe mjete të thjeshta të punës.

Neni 7

Kategoria e II ndërlíkueshmërisë së punëve – Përgatitja profesionale-Punëtor gjysmë i kualifikuar

Ndërlíkueshmëria e punëve:

Punë më pak të ndërlíkuaara në prodhim dhe shërbimet e përbashkëta, operacionet administrative dhe punët e ngjashme të cilat përsëriten dhe kryhen në mënyrë të thjeshtë dhe mjete teknike apo pa to, si dhe punë më pak të ndërlíkuaara me makinë apo aparaturë.

Neni 8

Kategoria e III ndërlíkueshmërisë së punëve – Përgatitja profesionale-Punëtor i kualifikuar

Ndërlíkueshmëria e punëve:

Punët e mesme të ndërlíkuaara dhe punët e ndryshme në prodhim, puna me makina të ndryshme, mjete e aparate, punët e mesme të ndërlíkuaara në administratë dhe shërbime të ngjashme. Për profesionin e këtyre kategorive

karakteristikë është kërkesa me kuptimin e shkallës më të lartë të bazës së procesit të punës, sepse janë të mundura situatat e paparashikuara të punës në të cilat punëtori vetë i zgjedhë problemet e paraqitura.

Neni 9

Kategoria e IV ndërlíkueshmërisë së punëve – Përgatitja profesionale- Kualifikim i mesëm profesional

Ndërlíkueshmëria e punëve:

Punët e ndërlíkua të nduardurshme, të cilat në prodhim kryhen me vegla e aparaturë të ndryshme. Punët e ndërlíkua në punët administrative, në përgatitjen e punës dhe përcjelljen e prodhimit të proceseve të punës e të ngjashme, vendet e punës për caktimin dhe kontrollimin e punës, përgatitjen e materialit dhe veglave për punë më pak të ndërlíkua dhe të mesme të ndërlíkua. Kuptimi i lajmërimeve në formë me shkrim, verbal e grafik, si dhe bartjen e atyre njoftimeve, zgjidhjen e problemeve konkrete, punëve më pak të ndërlíkua dhe të punëve të ndërlíkua.

Neni 10

Kategoria e V ndërlíkueshmërisë së punëve – Përgatitja profesionale- Punëtor me kualifikim superior

Ndërlíkueshmëria e punëve:

Operacionet e nduardurshme të ndërlíkua dhe shumë të ndërlíkua të cilat kryhen me vegla dhe aparate të ndryshme.

Punët e ndërlíkua dhe shumë të ndërlíkua në përgatitjen, përcjelljen, studimin dhe kërkimin analitik të prodhimit, punëve dhe proceseve të tjera të ngjashme.

Punët e ndërlíkua dhe shumë të ndërlíkua të cilat janë të nevojshme për udhëheqje organizative dhe operative, udhëheqjen profesionale të proceseve të punës, kontrollin e punës, kuadrove, udhëheqja ekonomike dhe administrative e njërive punuese me prodhim të nduardurshëm e të ndërlíkuar dhe proceset e punës. Punët shumë të ndërlíkua në veprimtaritë shoqërore në udhëheqjen, koordinimin dhe këshillimin në punë, në shërbimin për përgatitje, në përcjelljen, studimin analitik dhe kërkimin e prodhimit, si dhe procese tjera të punës.

Neni 11

Përvoja në punë

Bazuar në Rregulloren Mbi Marrëdhënien në Punë, punëtorëve iu bëhet pagesa për përvojë në punë 0,5% të pagës bazë për çdo vit të plotë të përvojës në punë.

Të ardhurat për kategoritë e punëtorëve në bazë të ndërlukshmërisë së punëve, përgjegjësisë, kualifikimit dhe kushteve të punës:

Poeni – vlera 20 Euro

Rroga minimale - 310 Euro

310 (Rroga minimale) : 20 Euro =15.5 (koeficienti)

15.5(koeficienti) X 20 Euro poeni = 310 Euro

	Kategorija e punëtorëve sipas ndërlukshmërisë së punëve, përgjegjësisë, kualifikimit dhe kushteve të punës	Emërimi i kategorisë së të punësuarve	Vlera e koeficientit 20 Euro	
			Rroga Bazë	Koeficienti
		<i>Punëtor Ekzekutiv të Shitjes në Teren (Inksantë)</i>	190	9.5
I	Punëtor të pa kualifikuar	<i>Rojtar</i>	310	15.5
II	Punëtor me kualifikim fillor	<i>Pastrueset Kafebërset</i>	350	17.5
		<i>Punëtorët fizik</i>	370	18.5
III	Punëtor me kualifikim të mesëm	<i>Teknik i Gjeodezisë Mirëmbajtës dhe manipulues të pompave</i>	390	19.5
		<i>Teknik - Laboratori në Analizat Bakteriologjike Teknik –Laboratori te Analizave Fiziko-Kimike Laborant Tereni Agjustator -Saldues në mirëmbajtje</i>	410	20.5
		<i>Mirëmbajtës dhe Manipulues i objekteve dhe Kanaleve Mirëmbajtës Ndërtimor Vozitës të automjetit Zyrtar për Marrëdhënie me Konsumator Referent për Kartotek Centralist Dispeqerat</i>	430	21.5

		<p>Mirëmbajtës i Mekanikës në SF Mirëmbajtës i Elektrikës në SF Faturist Arhiviste Zyrtar të Kontabilitetit Zyrtar të Kontabilitetit - Materialit Portoarkatar Kontroller, Lexues i amvisërisë</p>		
		<p>Shofer I Cisternës Shofer i minicisternës</p>	440	22
IV	<p>Punëtor me kualifikim të mesëm Profesional (Mjeshtrit, shoferët e automjeteve special) dhe punëtorët me përgjegjësi shtesë</p>	<p>Elektracist per mirëmbajtje dhe zhvillim Përgjegjës për Autopark Zyrtar për GIS-in Kontroller, Lexues të Bizneseve dhe Institucioneve dhe Ujëmatësve Kryesor Punëtor në Çkyçje Punëtor në njësinë e kontrollës Asistent teknik në sektorin për çështje ligjore Vozitës i automjetit (Kryeshefit Ekzekutiv) Monter Operator Eskavatori</p>	450	22.5
		<p>Detektues i Rrjedhave në Rrjet të Ujësjetllësit Shef i Grupit të mirëmbajtjes të ujësjetllësit për fshat Shef i Grupit të mirëmbajtjes të ujësjetllësit për qytet Shef i Grupit të Mirëmbajtjes së Kanalizimit Shef i Ndërrimit në Njësinë e Ujit të Pijes Depoist Qendra thirrjeve Shef i Grupit Ekzekutiv të Shitjes në Terren Furnizues</p>	470	23.5
		<p>Asistent i Faturimit</p>	490	24.5
		<p>Shef i Grupit të Çkyçjes Shef i Grupit të Kontrollës Asistent i Departamentit Teknik Shef i sektorit të Depove Asistent teknik Zëdhënëse</p>	500	25
		<p>Shef per Kesh dhe Bankë Administrator i Rrjetit Kompjuterik</p>	510	25.5

V	Kualifikim superior - Shefa të Sektoreve dhe Zyrtar	<p>Shef i sektorit të Faturimit Shef i sektorit për Shërbimet elektrike tensioni i Lartë Shef i sektorit për Shërbimet elektrike tensioni i Ulët Shef i sektorit për Sigurimin e Objekteve dhe Mbrojtjen në Punë të Punëtorëve Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim Shef i sektorit për Shërbime Makinerike Shef i sektorit Diga dhe Liqeni Zyrtar në Zyrën e Prokurimit Zyrtar i Kontabilitetit dhe Pasurisë Zyrtar Ligjor Zyrtar Hidroinxhinjer Shef i Njesisë së Ujit të Pijes Ekolog Zëvendës menaxher i cilësisë së laboratorit</p>	550	27.5
	Udhëheqësa të Njësive	<p>Udhëheqës i Njesisë të Prodhimit të Ujit të Pijes Udhëheqës të Njësive Operative të Mirëmbajtjes së Ujësjellësit dhe Kanalizimit Udhëheqës të Njesisë Të Marrëdhënieve me Konsumator Udhëheqës i Njesisë së Thesarit dhe Kontabilitetit Shef për personel Udhëheqës i Njesisë të Shitjes Menaxher i Njesisë së Laboratorit Udhëheqës i Njesisë për Planifikim dhe Zhvillim Zyrtar i lart i Raportimeve Shef i Sektorit të Gjeodezisë dhe GIS-it</p>	590	29.5
	Zyrtar të Lartë të Departamenteve, Menaxhera dhe Kryezyrtar	Auditori i Brendshëm	650	32.5
		Menaxheri i Departamentit Financiar		
Menaxheri i Administratës së Përgjithshme				
Zyrtar i logjistikes /këshilltar		670	33.5	
Menaxheri i aseteve		700	35	
	Menaxheri i Departamentit teknik	770	38.5	
	Menaxheri i Prokurimit			
	Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit			
	Sekretari i Korporatës	770	38.5	
	Zyrtar i Auditimit të Brendshëm			
Kryeshefi	Kryeshefi Ekzekutiv	1290	64.5	

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

Fatos Koshi